



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 294/1 Prot.

Tiranë, më 10.04.2019

**VENDIM**

**Nr.24, datë 10.04.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 24, DATË 13.04.2018, NË**  
**INSTITUCIONIN E BASHKISË MEMALIAJ**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 24, datë 13.04.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimi të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në Urdhrin nr. 75, datë 03.10.2018, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 24, datë 13.04.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Bashkia Memaliaj.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe detyrat e lëna për Bashkinë Memaliaj, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se:

✓ Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 24/2018, që ka lidhje me ligjshmërinë në materializimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, në strukturën organizative të institucionit, në përputhje me nenet 4 dhe 19, të ligjit për nëpunësin civil, është zbatuar rekomandimi sipas orientimit të lënë në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe në Vendimin e paralajmërimit nr. 24, datë 13.04.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Konkretisht, me Vendimin nr. 35, datë 10.08.2018, të Këshillit Bashkiak “Për një ndryshim në strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Memaliaj” (bashkëngjitur shkresës me nr. 656/1 prot., datë 14.08.2018, “Dërgim informacioni”, të Bashkisë Memaliaj), janë saktësuar pozicionet e punës, të cilat kanë karakteristikat e shërbimit civil. Struktura aktuale përfshin 32 pozicione pune në shërbimin civil, në krahasim me strukturën e vjetër që ishin vetëm 10 pozicione pune në shërbimin civil. Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Memaliaj ishin bërë publike edhe konkurrimet e reja, sipas strukturës, pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, vërtetuar kjo nga shpalljet e printuara nga faqja zyrtare e internetit e SHKP ([www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al)).

Gjithashtu, njësia e burimeve njerëzore e këtij institucioni, ka përgatitur edhe përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil.

✓ Në zbatim të pikës 3, të vendimit nr. 24/2018, që ka lidhje me përfundimin e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2017 dhe në vijim, për vitin 2018, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, pranë Bashkisë Memaliaj ka zbatuar orientimet e dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe në Vendimin e paralajmërimit duke plotësuar formularët e vlerësimit për çdo nëpunës civil. Gjithashtu ka orientuar edhe aktorët e tjerë të procesit, ndër të cilët eprorët e drejtpërdrejtë, si dhe ka përfshirë në Regjistrin Qendror të Personelit të gjithë formularët e vlerësimit për çdo nëpunës civil.

Konkretisht, nga ana e Bashkisë Memaliaj bashkëlidhur shkresës me nr. 656 prot., datë 01.06.2018, ndodhet një model formulari i vlerësimit të punës, i plotësuar konform kërkesave të ligjit. Gjithashtu, gjatë verifikimit pranë subjektit u konstatua se formularët e vlerësimit të punës ishin plotësuar konform kërkesave të ligjit për të gjithë nëpunësit civilë të institucionit.

✓ Në zbatim të pikës 4, të vendimit nr. 24/2018, që ka lidhje me planin vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil, vlerësoj se, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, pranë Bashkisë Memaliaj ka zbatuar rekomandimin sipas orientimit të lënë në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe në Vendimin e paralajmërimit duke miratuar planin vjetor të pranimeve të reja në shërbimin civil konform kërkesave të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*.

Konkretisht me aktin nr. 656/2 prot., datë 13.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë është detajuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, ku janë përcaktuar 17 pozicione të lira pune në shërbimin civil, për t’u plotësuar konform ligjit për nepunësin civil.

✓ Në lidhje me pikën 5, të vendimit nr. 24/2018, që ka të bëjë me respektimin e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i cili rregullon procesin e ristrukturimit, vërej se, nga krahasimi i strukturave nuk kishte ndryshim të pozicioneve ekzistuese të punës në shërbim civil dhe për rrjedhim, Bashkia Memaliaj nuk ka kaluar në proces ristrukturimi.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 24, datë 13.04.2018, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Memaliaj dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.24, datë 13.04.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Memaliaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**